

**Ftesë për pjesëmarrje në Konferencën Shkencore: “Historia ekonomike e Kosovës 1912-1999”.**

I/e nderuar,

Kemi kënaqësinë t'ju ftojme të merrni pjesë në Konferencën Shkencore: **“Historia ekonomike e Kosovës 1912-1999”**, e cila organizohet nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në bashkëpunim me Universitetin e Prishtinës - Fakultetin Filozofik, Institutin për Trashëgimi Shpirtërore dhe Kulturore të Shqiptarëve-Shkup dhe Universitetin e Elbasanit-Fakultetin e Shkencave Humane. Konferenca do të mbahet më 6 nëntor 2026 në Prishtinë.

#### **Tezat e konferencës:**

- Resurset ekonomike të Kosovës.
- Rrethanat ekonomike në Kosovë: Nga okupimi te Lufta e Parë Botërore 1912-1918.
- Politikat kolonizuese-ekonomike në Kosovë ndërmjet dy Luftërave Botërore.
- Eksploatimi i burimeve natyrore të Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore.
- Politikat ekonomike të Jugosllavisë ndaj Kosovës 1945-1966.
- Zhvillimi ekonomik i Kosovës në periudhën 1966-1989.
- Relacioni politik dhe zhvillimi ekonomik gjatë ndryshimeve kushtetuese të Kosovës.
- Rrënimi ekonomik i Kosovës në vitet e 90-ta të shek. XX.
- Shkatërrimi i ekonomisë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999.
- Kontributi i diasporës në përkrahjen e ekonomisë në Kosovë.

#### **Afatet për dorëzimin e abstrakteve dhe kumtesave të plota:**

- Afati për dorëzimin e abstrakteve: 31 mars 2026, në adresën e emailit: [instituti.historis@rks-gov.net](mailto:instituti.historis@rks-gov.net)
- Njoftimi për miratimin e kumtesave: 9 prill 2026.
- Afati për dorëzimin e punimeve të plota më 6 nëntor 2026, me rastin e prezantimit të kumtesës në Konferencë.

Kumtesat dhe rezultatet e kërkimeve shkencore të pjesëmarrësve në Konferencë, sipas përcaktimit të redaksisë, do të botohen në përmbledhje të veçantë apo në një edicion të veçantë në revistën shkencore të Institutit.

Pas konferencës, dorëshkrimet do t'i nënshtrohen një procesi recensimi nga redaksia e botimit. Pas shqyrtimit, bordi do t'u dërgojë autorëve email me komente dhe sugjerime. Autorët duhet të rishikojnë dorëshkrimet e tyre bazuar në këto kërkesa redaktoriale dhe të dorëzojnë draftin përfundimtar deri më datë 30 dhjetor 2026.

Për informacion shtesë ju lutemi të na kontaktoni në adresën e emailit: [instituti.historis@rks-gov.net](mailto:instituti.historis@rks-gov.net)

**Me respekt, Teuta SHALA-PELI**  
**Drejtoresh e Institutit të Historisë “Ali Hadri”.**